

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga Kryetari i Gjykatës Enver Peci, kryetar kolegji dhe gjyqtarët Emine Mustafa dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të pandehurit M.M., nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 pika 3.1 të KPRK-së dhe veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, Ppr.nr.580/2017 të datës 11.12.2017, dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.2246/2017 të datës 18.12.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 09.01.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit M.M., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, Ppr.nr.580/2017 të datës 11.12.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.2246/2017 të datës 18.12.2017.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin Ppr.nr.580/2017 të datës 11.12.2017, të pandehurit M.M., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 pika 3.1 të KPRK-së dhe veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së, të njëjtit i ka caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaj duke llogaritur prej datës 11.12.2017 deri

më 11.01.2018, sipas dispozitës së nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.2 dhe pika 1.2.3 të KPPK-së.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin PN.1.nr.2246/2017 të datës 18.12.2017, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit, dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit M.M., av. Arben Shala nga Prizreni, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që të aprovohet kërkesa si e bazuar dhe të konstatohet se aktvendimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal.

Prokurori i Shtetit Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.01/18 të datës 05.01.2018, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësi i të pandehurit M.M., ndër të tjera thekson se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë me aktvendimet e tyre nuk kanë vlerësuar faktet vendimtare për vendosjen e drejtë të çështjes, se me qëndrimin e të mbrojturit të tij në paraburgim të njëjtit i është rrezikuar gjendja ekonomike edhe ashtu e vështirë, se të mbrojturit të tij i dihet identiteti ashtu që ai nuk mund të fshihet as të arratiset as të ndikoj në dëshmitar apo të dëmtuar pasi që jeton në një bashkësi familjare gjegjësisht në të njëjtën shtëpi me të dëmtuarën. I pandehuri siç theksohet në kërkesë, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej veprime të kundërligjshme, andaj mbrojtësi i të pandehurit nga të theksuarat si më lartë i

propozon gjykatës që t'i ndërpritet masa e paraburgimit duke i caktuar ndonjë masë tjetër alternative - masën e lajmërimit në stacionin policor.

Sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk janë të bazuara, ngase siç shihet nga shkresat e çështjes, kallëzimi penal, aktvendimi për fillimin e hetimeve dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë, rezultojnë se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën dyshohet, kurse a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat tjera të procedurës penale, me çka është plotësuar kushti ligjor nga neni 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPPK-së, për caktimin e paraburgimit ashtu siç me të drejtë kanë vlerësuar gjykatat e instancës më të ultë.

Kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit konform nenit 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.2 të KPP, ngase me qëndrimin e të pandehurit në liri apo nën ndonjë masë tjetër alternative ekziston rreziku i asgjësimit, fshehjes apo ndryshimit të provave të veprës penale, ose duke ndikuar në dëshmitar apo të dëmtuar të cilët ende nuk janë dëgjuar në prokurori.

Gjithashtu, kjo Gjykatë vlerëson se drejtë është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, se ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit edhe konform nenit 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.3 të KPP, duke pasur parasysh peshën e rëndë të veprës penale, mënyrën e kryerjes dhe rrethanave në të cilat dyshohet se është kryer vepra penale, në shtëpi duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore nënës së tij H.M., në atë mënyrë që derisa e dëmtuara ishte duke qëndruar në dhomë së bashku me bijtë A. dhe O., i pandehuri hynë në dhomë ku fillimisht i drejtohet të dëmtuarës me fjalë fyese e më pastaj acarohet me vllaunë e tij O. M., kur e dëmtuara e frikësuar duke tentuar t'i lajmëroj komshinjtë, i pandehuri e godet të dëmtuarën me grushta në kokë, me çka nga këto veprime të njëjtës i shkakton lëndime të lehta trupore, e më pastaj në gjendje të revoltuar, i njëjti del nga shtëpia dhe me të ofruar afër lokalit afarist "Diti Mobile" i then xhamat e lokalit, me çrast të dëmtuarit E.Z., i shkakton dëm material.

Nga arsyet e mësipërme, kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal, siç pretendon mbrojtësi i të

pandehurit cilat do të kishin ndikim në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, sepse gjykata shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë ka bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendime për caktimin e paraburgimit duke dhënë edhe arsytet të mjaftueshme, vlerësime të cilat si të drejta dhe ligjore i pranon edhe kjo gjykatë me theks të veçan se masat tjera të parapara nga neni 173 të KPPK-së, janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale në këtë çështje penalo-juridike.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimin.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.1/2018 datë 09.01.2018

B. profesional,
Sherif Krasniqi

Kryetari i Gjykatës - kolegjit,
Enver Peci